

Emri i Lëndës : E Drejtë Familjare II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 216	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00
<b>Lektori</b>		Ada Güven, PhD					
<b>Asistenti</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>		Shqip					
<b>Niveli i lëndës</b>		Program i Integruar					
<b>Përshkrimi</b>		E drejta familjare, trajton në mënyrë analitike e sistematike institutin e familjes dhe marrëdhëniet familjaro-juridike që rrjedhin prej saj, në mënyrë që të arrihet një trajtim njohës e shkencor i atyre problematikave që përbëjnë themelin e kësaj dege të së drejtës private. Ky kurs synon të pajisë studentin me njohuri të plota mbi fëmijët, amësinë, atësinë, përgjegjësinë prindërore dhe përgjegjësinë shoqërore mbi fëmijët. Lënda do të fokusohet në tema bashkëkohore që diskutohen kudo lidhur me mbrojtjen ligjore të fëmijëve duke evidentuar edhe problematikën që kanë lindur në shoqërinë shqiptare duke dhënë edhe zgjidhjet ligjore të parashikuara nga legjislacioni vendas dhe ndërkombëtar i ratifikuar nga Shqipëria. Po ashtu, ky kurs synon të informojë studentët me disa institute të rëndësishme si birësimi, kujdestaria etj.					
<b>Objektivat</b>		Qëllimi dhe objektivi i kësaj lënde është aftësimi i studentëve në kuptimin e drejtë të marrëdhënieve ligjore familjare dhe interpretimin e normave dhe legjislacionit në fushën e së drejtës familjare. Kursi synon gjithashtu dhe edukimin për një kuptim të drejtë ligjor e shoqëror të marrëdhënieve prind- fëmijë apo shoqëri-fëmijë duke shprehur dhe shkeljet e ndryshme që ndodhin në këtë kuadër. Kjo lëndë synon të japë një trajtim të plotë të problematikës së dhunës në familje pasi vlerëson që është një problem relativisht i përhapur në shoqëri. Nëpërmjet studimit dhe diskutimit të kazuseve, studentët do të përgatiten për të argumentuar drejtë vendime gjyqësore, si dhe për t'i mbështetur ato në provat e administruara gjatë procesit gjyqësor					
<b>Konceptet Kryesore</b>		1. Përgjegjësia prindërore 2. Amesia 3. Birësimi 4. Atesia 5. Kujdestaria 6. Pjestimi i pasurisë 7. Pasuri e Bashkësisë 8. Regjime Pasurie					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve Ky leksion synon të analizohet dispozitat e lidhura me të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve të parashikuara nga nenet 50-65.						
2	Kuptimi dhe parimet të përgjithshme të regjimit pasuror martesor Leksioni jep kuptimin dhe parimet kryesore të regjimit pasuror martesor. Përcakton rregullat për caktimin dhe ndryshimin e regjimit pasuror. Do të trajtohet në mënyrë të detajuar regjimi pasuror në bashkësi, pra bashkësia ligjore. (Fq. 215-253)						
3	Regjimet pasurore vazhdim Kjo temë trajton vazhdimin e regjimit pasuror duke përcaktuar rregullimet dhe udhëzimet për regjimin e bashkësisë me kontratë dhe regjimin e pasurive të ndara. Kështu, shpjegon të drejtat dhe detyrimet që ka secili prej bashkëshortëve në këto regjime. (Fq. 253-263)						
4	Pasojat e zgjidhjes së martesës Kjo temë trajton pasojat e zgjidhjes së martesës si fitimi i statusit të shkurorëzimit, e drejta e përdorimit të mbiemrit ose jo, mbarimi i regjimit pasuror martesor, detyrimi i kontributit kompensues si dhe pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët. (Fq. 325-338)						

<b>5</b>	Amësia e fëmijës; Njohja dhe kundërshtimi i amësisë Në këtë leksion përcaktohet çfarë është amësia , si bëhet njohja e amësisë duke përfshirë njohjen vullnetare dhe gjyqësore. Gjithashtu, trajtohen llojet e subjekteve të cilët mund të bëjnë kundërshtimin e amësisë së fëmijës. (Fq. 376-396)
<b>6</b>	Atësia e fëmijës; Njohja dhe kundërshtimi i atësisë Në këtë leksion përcaktohet çfarë është amësia dhe atësia, si bëhet njohja e atësisë dhe amësisë duke përfshirë njohjen vullnetare dhe gjyqësore. Gjithashtu, trajtohen llojet e subjekteve të cilët mund të bëjnë kundërshtimin e amësisë dhe të atësisë së fëmijës. (Fq. 376- 396)
<b>7</b>	Provim Gjysme final
<b>8</b>	Detyrimi për ushqim Ky leksion synon të analizohet dispozitat e lidhura me detyrimin për ushqim të parashikuara nga nenet 192-214.
<b>9</b>	Përgjegjësia prindërore, kuptimi dhe përmbajtja Në këtë temë trajtohet kuptimi i përgjegjësisë prindërore, qëllimet dhe parimet e saj. Gjithashtu, përcaktohet shtrirja në kohë e përgjegjësisë prindërore duke përcaktuar momentin e fillimit dhe të mbarimit të përgjegjësisë prindërore. Në përfundim jep mënyrat e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (Fq. 397- 424)
<b>10</b>	Përgjegjësia prindërore vazhdim Në këtë leksion do të trajtohet ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, ushtrimi vetëm nga një prind, nga të tretët si dhe përgjegjësia prindërore lidhur me përfaqësimin, administrimin dhe përdorimin e pasurisë së të miturit. Në përfundim jepet rastet e heqjes dorë nga përgjegjësia prindërore. (Fq. 425-461)
<b>11</b>	Birësimi Në këtë leksion do të trajtohet baza ligjore, kuptimi dhe qëllimi i institutit të birësimit, do të përcaktohet statusi i të birësuarit si dhe do të shpjegohet procedura e birësimit përfshirë procedurën administrative dhe gjyqësore. Po ashtu, do të analizohet birësimi ndër vendas. (Fq. 462-490)
<b>12</b>	Kujdestaria Kjo temë trajton kuptimin dhe karakteristikat e kujdestarisë. Po ashtu, përcaktohet procedura për caktimin e kujdestarit dhe mënyrat e ushtrimit të kujdestarisë. Krahas kësaj analizohen edhe detyrat dhe të drejtat e kujdestarit dhe e të miturit si dhe kujdestaria e posacme dhe kujdestaria mbi personat madhorë. (Fq. 491-520)
<b>13</b>	Konventa për të drejtat e fëmijëve Ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.
<b>14</b>	Ligji nr.9359, datë 24.03.2005 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët” Ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të ligjit nr.9359, datë 24.03.2005 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”.
<b>15</b>	Praktikë gjyqësore Pasurimi i leksioneve duke integruar praktikën gjyqësore lidhur me temat e trajtuara në kuadër të kësaj lënde gjatë semestrit akademik.
<b>16</b>	Provim Final

<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arta Mandro, E Drejta Familjare Familja: Fëmijët, Martesa dhe Bashkëshortët (EMAL 2009)</li> <li>• Kodi i Familjes (Qendra e PublikimeveZyrtare 2012)</li> </ul>
<b>Referenca të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sonila Omari, E Drejta Familjare (Botimet Morava 2012)</li> <li>• Legjislacioni për Birësimet i R.Sh.. (Qendra e PublikimeveZyrtare 2012)</li> <li>• Ligji nr. 9443, Datë 24.03.2005. Për Aderimin e R.Sh. në Konventën “Për Juridiksionin, Ligjin e zbatueshëm, njohjen,zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”.</li> </ul>
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>	
<b>1</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë marrëdhënien juridike familjare.
<b>2</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë të informuar mbi konceptin e atësisë, amësisë, njohjen dhe kundërshtimin e tyre.
<b>3</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë të drejtat e fëmijëve dhe kornizën ligjore që i mbron ata.
<b>4</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të kenë marrë konceptet kryesore të përgjegjësisë prindërore, ushtrimi vetëm nga një prind; ushtrimi i përgjegjësisë prindërore nga të tretët; përgjegjësia prindërore për perfaqësimin, administrimin dhe përdorimin e pasurisë së të miturit
<b>5</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë të pajisur me njohuri mbi birësimin, kujdestarinë dhe masat që duhen marrë lidhur me dhunën në familje.

<b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>			
<b>Notat e Ndërmjetme</b>	<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>40</b>	
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>60</b>	
<b>Total</b>		<b>100</b>	
<b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>			
<b>Aktivitetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>	<b>Ngarkesa Totale (orë)</b>
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>101</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>4.04</b>
<b>ECTS</b>			<b>4.00</b>